

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “Dama Hotel ”

Personat qe firmosin me poshte:

Znj. Rei Dama, lindur me 18.01.1997, banues ne Tirane, me karte identiteti id: J75118049M, me shtetesi dhe kombesi shqiptare,

Znj. Anisa Gjoka, lindur me 03.03.1987, banues ne Tirane, me karte identiteti id: I75303073H, me shtetesi dhe kombesi shqiptare,

kane hartuar, si me poshte vijon, Statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 1. Forma

Ortaket si dhe pronar te pjeseve te krijuara sic tregohen me poshte dhe te atyre qe mund te behen pronare te pjeseve eshte krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, e cila ushtron veprimtarine e saj e perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanrisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise ,si dhe me dispozitat e ketij Statutit .

Regjimi juridik i shoqerise mund te ndryshoje me vendim unanim te “ortakeve”.

Neni 2. Objekti

Shoqeria ka per objekt:

Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e hotelerise duke perfshire fjetjen dhe mengjesin.

Neni 3. Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte **Dama Hotel**.

Neni 4. Vendodhja e selise

Selia e shoqerise e caktuar ne :

Rruga e Dibres, Nd nr. 57, Njesia Bashkiake nr. 4, Zk. 8360, nr. Pas 7/85 Tiranë.

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter te rrethit, ose mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjithshme

te jashtezakonshme te ortakeve. Ajo me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dhe mbylle filiale, dege ose zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 5. Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar 50 (pesedhjete vjet) duke filluar nga data e rregjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpjtuar ose zgjatja e afatit behen me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te ortakeve.

Neni 6. Pergjegjesia e shoqerise

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj ndaj te treteve vetem me pasurine e saj. Ortaket e shoqerise nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjen e saj, pervecse ne masen e vleres nominale te pjeseve ne kapitalin themeltar.

Neni 7. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i nenshkruar i pa paguar, eshte caktuar ne vlere prej 100 (njqind) leke dhe zoterohet nga ortaket ne mase 50 % secili prej tyre.

Ai eshte i ndare ne 2 pjese.

Kontributi (kapitali aksionar) i ortakeve eshte ne para (leke).

Personi qe firmos kete akt pasi ka mare dijeni per kete certificate, nje kopjo ekzakte e se ciles i eshte paraqitur atij, deklaron se shuma e mesiperme eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne certificate dhe se ato konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit aksionar ne perputhje me shumen respective te derdhur.

Neni 8. Llogaria rrjedhese

Ortaku mund ti japi shoqerise fonde ne llogari rrjedhese. Menytrat e funksionimit te ketyre llogarive vendosen ne cdo rast nga administratori dhe te interesuarit.

Neni 9. Zmadhimi i kapitalit aksionar

Kapitali aksionar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Zmadhimi i kapitalit aksionar mund te kryhet vetem me vendim te asamblese te jashtezakonshme te ortakeve, ne baze te raportit te Drejtorise, i cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Asambleja mund t'i delegeje drejtorise kompetencat e nevojshme per te realizuar zmadhimin e kapitalit nje, ose disa here, per te fiksuar modalitetet, per te ndjekur realizimin dhe per te proceduar ne ndryshimin perkates ne statut.

Neni 10. Menyra e fitimit dhe kalimit te kuotave (pjeseve te kapitalit)

Kuotat (pjeset) e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise,
- b) shitblerjes,
- c) trashegimise,
- d) dhurimit,
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Pjeset e kapitalit mund t'ju transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se otrakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit dhe me kushte jo me te favorshme se ato qe i jane ofruar ortakeve.

Cdo ortak qe kerkon te terhiqet nga shoqeria duhet t'a motivoje kete terheqje perpara asamblese se ortakeve me anen e kerkeses me shkrim. Ortaku qe kerkon te terhiqet nga shoqeria duhet t'ua afroje pjeset e tij per blerje ortakeve ekzistues. Kur keta nuk deshirojne ka te drejte t'ua shese ato te treteve, jo ortake te cilet duhet te miratohen paraprakisht nga asambleja e ortakeve e cila zbaton te gjitha kerkesat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Terheqja nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e tij te meparshme ndaj shoqerise, dhe as shoqerine nga detyrimet e meparshme kundrejt ortakut.


Neni 11. Transferimi ne rast vdekje dhe ndarjeje pasurie mes bashkeshorteve

Ne rastin e vdekjes te nje ortaku pjeset e tij jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, ku trashegimtaret ligjore ashtu edhe trashegimtaret me testament, sic jane percaktuar keta nga Kodi Civil neni 360 dhe 372.

Edhe ne rastin e nje ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve, sepse pas zgjidhjes se marteses, pjeset ne kapitalin themeltar mund t'i jepen bashkeshortit jo ortak ne shoqeri.

Neni 12. Veprimtaria e shoqerise

Zhvillimi i veprimtarise se shoqerise bazohet ne parimet ekonomike dhe ne respektimin e kerkesave te legjislacionit ne fuqi si edhe te rregullave te ushtrimit te aktivitetit privat. Veprimtaria financiare e shoqerise dhe rezultatet e saj pasqyrohen ne llogarite e shoqerise dhe ne raportin e administratorit.



Neni 13. Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti i pare financiar kur do te nise veprimtaria e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14. Inventari, Llogarite vjetore

Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt ne pajtim me ligjin.

Librat kontabel mbahen ne gjuhen Shqipe.

Shoqeria realizon transaksione ne leke dhe valute. Konvertimi i llogarive ne valute ne fund te vitit behet perkatesisht me kursin zyrtar.

Ne mbyllje te cdo ushtrimi financiar Drejtoria harton inventarin e elementeve te ndryshem te aktiveve dhe te detyrimeve ne kete date, si dhe llogarite vjetore te shoqerise.

Drejtoria harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e ardheshme te parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis dates kur eshte hartuar raporti, dhe veprimet e kerkimit e te zhvillimit.

Neni 15. Rezultati, caktimi dhe shperndarja

Rezultati i veprimtarise percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe shpenzimeve, qe i perkasin ushtrimit financiar. Nga fitimet e ushtrimit pasi te jene zbritur, kur eshte rasti, humbjet e mepareshme, hiqet te pakten 5% per te krijuar fondet e rezerves te domosdoshme. Kur kjo rezerve arrin 1/10 e kapitalit themeltar nuk behen me heqje nga fitimet e ushtrimit.

Fitimi i shperndashem formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjen e meparshme dhe shumat e hequra per rezervat dhe duke shtuar fitimet e pashperndara te tresheguara.

Megjithkete, pas heqjes te shumave per t'u kaluar ne rezerve ne zbatim te ligjit, asambleja e pergjithshme, mund te heqe cdo shume qe ajo e gjykon te pershtatshme per te krijuar rezerva te zakonshme ose te jashtezakonshme ose per te mbartur shumen ne ushtrimin e ardhshem.

Fitimi i shperndashem qe mbetet shperndahet ndermjet ortakeve perpjestimisht me numrin e pjeseve qe i perkasin secilit.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose venien ne shperndarje te shumave qe ajo heq nga rezervat qe ka ne dispozicion. Megjithate, dividendet caktohen ne radhe te pare nga fitimet e shperndarshem te ushtrimit.

Perjashtuar rastin kur vendoset zvogelimi i kapitalit, ortakeve nuk mund t'u behet asnje shperndarje ne qofte se si rrjedhoje e shperndarjes kapitalet e veta te shoqerise jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit te kerkuar nga ligji plus rezervat qe nuk mund te shperndahen.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose mos venien ne shperndarje te shumave te fitimeve kur ajo i ri investon ne shoqeri, kur ajo ka huara ndaj bankave e institutive te kreditimit.

Neqofte se eventualisht ndonje ushtrim financiar mbyllet me humbje, shuma e humbjes pas miratimit te llogarive vjetore nga asambleja, mbartet ne ushtrimin vijues, per t'u mbuluar nga fitimet e ushtrimeve te ardhshem deri ne shuarjen e saj.

Neni 16. Menyrat e pagimit te dividendeve, Paradheniet

Asambleja e pergjithshme ka te drejte t'i jape cdo ortaku per te gjithe ose per nje pjese te dividendeve nje opsion midis pagimit ne para ose ndonje forme tjeter qe percaktohet me ligj.

Menyrat e pagimit te dividendeve ne para caktohen nga asambleja e pergjithshme, ose ne mungese te saj, nga drejtoria. Pagimi i dividendeve ne para duhet te kryhet brenda nente muajve pas mbylljes se ushtrimit financiar, pervec kur ky afat zgjatet me vendim te gjykates.

Drejtoria mund te vendose pagimin e dividendeve perpara mbylljes te ushtrimit ne forme paradhenie por me respektimin e kerkesave te parashikuara nga ligji.

Neni 17. Organet e shoqerise

Organet e shoqerise jane:

- a)Asambleja e ortakeve,
- b)Administratori.

Neni 18. Perberja e asamblese

Asambleja e ortakeve eshte autoriteti me i larte drejtues i shoqerise. Ajo formohet nga te gjithe ortaket pamvaresisht nga numri i pjeseve ne kapitalin themeltar qe zoterojne. Sipas natyres te vendimeve te shoqerise qe eshte thirrur per te marre, asambleja eshte e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asamblete kryesohen nga nje anetar, i zgjedhur nga ortaket. Kryetari i asamblese emerohet nje sekretar qofte dhe jo ortake.

Neni 19. Asambleja e pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a)percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b)ndryshimet ne statut,
- c)emrimin e shkarkimin e administratorit,
- d)emrimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
- e)mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f)miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- g)zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit,
- gj)pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h)perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- i)riorganizimin e dhe prishjen e shoqerise,



j) miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese,

k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Asambleja e pergjithshme merr vendime per ceshtje te percaktuara ne shkronjat "f" dhe "g" te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkates.

Vendimet e asamblese se pergjithshme te marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Te regjistrohen ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,

b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve,

c) investimet,

d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 20. Administratori

Shoqeria administrohet nga nje Administrator, qe duhet te jene persona fizike dhe mund te jete ose jo ortak ne shoqeri.

Shoqeria do te administrohet nga **Znj. Rei Dama**.

Administratori emerohet nga asambleja e pergjithshme. Ai i kryen te gjitha veprimet zyrtare qe kane te bejne me krijimin e shoqerise.

Ne te ardhmen shoqeria mund te administrohet edhe nga administrator tjetër, i cili emerohet me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 21. Perfaqesimi te te tretet

Ne marredhenie me te tretet shoqeria perfaqesohet nga administratori.

Neni 22. Kompetencat e ortakeve dhe administratorit

Ortaket dhe administratori ushtrojne te gjitha kompetencat, te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e shoqerise, te cilat parashikohen nga ky statut, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Kompetencat e administratorit jane:

-Organizimi i veprimtarise se shoqerise per te plotesuar programin qe buron nga objekti i veprimtarise se saj.

-Administrimi i pergjithshem i shoqerise.

- Perfaqeson shoqerine para autoriteteve gjyqesore, te arbitrimin dhe administrative.
- Administron pasurine dhe aktivet financiare te shoqerise, brenda kufijeve te caktuar nga ortaket.
- Te leshoje dokumente zyrtare ne emer te shoqerise per te punesuarit e shoqerise dhe ne pergjithesi per palet e treta.

Neni 23. Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Ne rast nevojje ose nese e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar nga asambleja e ortakeve, duke filluar nga data e emrimit te tyre me mundesi rizgjedhje nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

Neni 24. Rregullariteti i marredhenieve te punesimit

Marredheniet midis shoqerise, filialeve, degeve ose zyrave te perfaqesimit te saj nga njera ane dhe te punesuarve nga ana tjeter, rregullohen me kontraten e punes dhe kontrates se sherbimit sipas kerkesave baze te legjislacionit te punes ne fuqi.

Neni 25. Detyrimi per ruajtjen e sekretit

Ortaket e shoqerise si dhe cdo person tjeter qe asiston ne mbledhjen e ketyre organeve duhet te ruajne fshehtesine per ceshtjet dhe te dhenat qe kane karakter te brendshem.

Neni 26. Menyra e thirrjes

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Ne rast se asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper te ketij neni, ajo mune te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 27. Hyrja ne asamble

Cdo ortak, pavaresisht nga numri i pjeseve qe zoteron, ka te drejte te asistojte ne mbledhjet e asamblese te pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin.

Cdo ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese dhe perfaqesuesi duhet te pajiset nga ortaku me mandatin e posacem, ne kushtet e parashikuar nga ligji.



Neni 28. Mbledhja e asamblese se pergjithshme

Asambleja e pergjithshme mbildhet ne rastet e percaktuara ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, si dhe nga ligje te tjera, ose dispozitat e statutit dhe sa here eshte qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur intereset e shoqerise.Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortakët e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 29. Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces-verbalet

Per cdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete-pranie e cila permban treguesit qe provojne identitetin e ortakut dhe pjeset e zoteruara prej tij.

Procesverbalet e asamblese te zakonshme apo te jashtezakonshme, hartohen nga sekretari dhe kunderfirmohen nga kryetari i asamblese. Ne procesverbalet e asamblese duhet te pasqyrohen qofte edhe me nje kerkese te nje ortakut te vetem deklaratat e tij.

Proces-verbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje regjister te posacem, i numeruar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

Neni 30. Fuorumi, votimi, numerimi i votave

Ne asamblene e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e pjeseve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

E drejta e votes qe ju perket ortakëve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Cdo pjese e kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte.

Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.

Neni 31. Venia ne dispozicion te ortakëve te dokumentave dhe informacioneve

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te ortakëve ne kushte dhe ne afate te parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion ortakëve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

Neni 32. Transformimi i shoqerise

Transformimi i shoqerise nga forma e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime behet me vendim te asamblese se ortakeve, duke u pasuar nga ndryshimet respektive te statutit, por ne asnje rast nuk mund te ndryshohet objekti i veprimtarise per te cilin ajo eshte krijuar.

Neni 33. Prishja, Likuidimi

Shoqeria priset:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtare tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjet nr.9723, date 03.05.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",
- f) me vendim gjykate.

Pervec rastit te bashkimit ose te ndarjes, prishja e shoqerise, per cfare do shkakut qofte, sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga nje ose disa likuidatore te emeruar nga asambleja e pergjithshme e zakonshme ose nga asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ne kushtet e quorumit dhe te shumices per asamblete e zakonshme.

Likuidatori perfaqeson shoqerine.

Likuidatori mund te kryeje aktet e nevojshme per likuidim dhe, po qe se anetaret nuk kane parashikuar ndryshe, mund te shesin edhe ne bllok pasurine e shoqerise dhe te bejne marreveshje e kompromise (shih. Kodin Civil).

Likuidatori nuk mund te ndermarre veprime te reja. Ne rast te kundert ata pergjigjen personalisht dhe solidarisht (kur jane me shume se dy likuidatore) per punet e filluara (K.C.).

Likuidatori ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditorët dhe per te shperndare mbetjet e disponueshme.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te autorizojë likuidatorin te vazhdojë ceshtjet ne proces ose te ndermarre ceshtjet te reja per nevojat e likuidimit.

Aktivi neto i mbetur ndahet midis ortakeve ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapital.

Neni 34. Kundershtimet

Te gjitha kundershtimet, gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likuidimit te saj, qe lindin midis shoqerise dhe ortakeve ose midis vete ortakeve, lidhur me veprimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.



Neni 35. Dispozita Te tjera

Te kryhen te gjitha formalitet per depozitimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, dhe pergjithesisht, per te kryer te gjitha formalitet e kerkuara nga ligji.

Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut te shoqerise do te zbatohen dispozitat ne fuqi te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise.

Vula e shoqerise mund te ndryshoje vetem me vendimin e asamblese se ortakeve.

Hartuar ne Tirane, me 08.11.2023

Ne 4 (kater) ekzemplar sa kerkon ligji

**NENSHKRUES
ORTAKET**

Znj. Rei Dama

Znj. Anisa Gjoka

